



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.101/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSh “D...” me seli në Kaçanik, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.B, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1185/17, të datës 06.07.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit NTSh “D...” me seli në Kaçanik, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.1185/17, të datës 06.07.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1185/17, të datës 06.07.2020 është refuzuar kërkesëpadia e paditësit NTSh “D...” me seli në Kaçanik, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.B, avokat në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/268 i datës 02.06.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe që të detyrohet e paditura që paditësit ti kthej mjetet financiare të paguara në emër të gjobës në shumë prej 4,807.14 (katërmijë e tetëqind e shtatë euro e katërmëdhjeta centë) si e pabazuar, ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi, nr.01.3.2.2/268 i datës 02.06.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë si dhe secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet e bazuar ankesa e paditësit NTSh “D...” me seli në Kaçanik si dhe të priset Aktgjykimi Anr.1185/17 i datës 06.07.2020 i Gjykatës themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative/Divizioni Fiskal dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së dytë. shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së,

nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/268 i datës 02.06.2017 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë NTSh "D..." me seli në Kaçanik, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.B, avokat në Prishtinë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr.08.1.2-2017-147/2 i datës 14.04.2017, i lëshuar nga Dogana e Kosovës-Sektori për Kundërvajtje Doganore Prishtinë.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/268 i datës 02.06.2017 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, e pas administrimit të provave si në procesverbale të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pabazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se gjykata ka konstatuar se e paditura Dogana e Kosovës në procedurën e ankesave ka konfirmuar aktvendimin nr.08.1.2-2017-147/2 i datës 14.04.2017 i lëshuar nga Dogana e Kosovës-Sektori për Kundërvajtje Doganore Prishtinë, me të cilin vendim paditësi është shpallur përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes doganore nga neni 276 pika (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, për shkak se me datën 13.04.2017 në ZBD Hani i Elezit duke vepruar në cilësi të përfaqësuesit të subjektit-importuesit NTSh "E..." me seli në Kaçanik kontrollës doganore nuk i ka paraqitur vlerën e saktë të mallit, pasi që në DUD R-8897/13.04.2017 për qëllime të llogaritjes së detyrimeve importuese ka deklaruar mallin me zbritje prej 5,377.12€ ndërsa vlera e mallit në faturë ka qenë në shumë prej 21,654.00€, veprim ky që ka rezultuar me tentimin për shmangien e taksave doganore në shumë prej 1,602.38€. Gjykata konstaton se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar drejt, pasi që me rastin e vendosjes së vlerës totale të mallit ka vendosur shumën totale të faturës prej 21,654.47€, sic shihet në DUD-in kontestues në rubrikën 22 të tij, ndërsa ka minusuar shumën prej 5,377.12€, sipas letër kreditit të lëshuar nga eksportuesi, ku ishte korrigjuar çmimi total i faturës për këtë vlerë, për arsye se edhe vet paditësi në padi por edhe gjatë shqyrtimit kryesor përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka pranuar faktin se dokumenti i lëshuar nga eksportuesi i emëruar letër krediti me nr.1000001143 i datës 12.04.2017, për korrigjimin e çmimit të përfshirë në faturën bazë me nr.1000001132 të datës 05.04.2017 nuk i ishte bashkangjitur dokumentacionit përcjellës të mallin në procedurën e zhdoganimit të mallit. Pikërisht këtë fakt e ka konstatuar edhe e paditura me aktvendimin nr.08.1.2-2017-147/2 i datës 14.04.2017 të Sektorit për Kundërvajtje Doganore në Prishtinë me të cilin paditësi ishte shpallur përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes doganore, sepse paditësi gjatë zhdoganimit të mallit, respektivisht në momentin e paraqitjes së mallit për zhdoganim për qëllime të llogaritjes së taksave doganore kishte deklaruar vlerë më të ulët në shumë prej 5,377.12€, nga vlera e faturës bazë e cila kishte vlerën prej 21,504.47€, dhe me këtë veprim ka tentuar që të paguajë më pakë taksa doganore në shumë prej 1,602.38€.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejt ka konstatuar se padia e paditësit është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka shpërfaqur provat e ofruara nga paditësi dhe se gjykata ka nxjerr konkluzion të gabuar në dëm të paditësit duke konsideruar edhe si shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale. Gjithashtu janë të pa bazuara, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pabazuara, dhe se të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ngase, aktvendimi i organit administrativ i të paditurës, është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke u bazuar në nenin 88 par.1 të UA 11/2009 për Implementimin e Kodit të Doganave dhe të Akcizës nr.03/L-109 është parashikuar se *“kur është i nevojshme përcaktimi i vlerës doganore në kuptim të nenit 32 deri në 40 të Kodit, deklarata në vlerën doganore (deklaratën për vlerën), e shoqëron fletëparaqitjen doganore të përpiluar në lidhje me mallin përkatës. Deklarata mbi vlerën përpilohet në formularin D.V. 1 që korrespondon me mostrën në aneksin 14. Të shtohet aty ku është e duhur nga një apo më shumë formularë D.V.1 bis, që korrespondon me mostrat në aneksin 15”*, ndërsa në paragrafin katër të po këtij neni është paraparë që *“Dorëzimi i deklaratës mbi vlerën e cila kërkohet sipas paragrafit 1 të këtij neni me mundësit e aplikimit të dispozitave ndëshkimore, personi i paraparë në paragrafin 2 është përgjegjës për: -Saktësinë dhe kompletimin e të dhënave të përmendura në deklaratë, - Autenticitetin e dokumenteve të ofruara për të mbështetur ato të dhëna dhe – Dorëzimi i të gjitha të dhënave shtesë dhe të dokumentacionit të nevojshëm për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave”*.

Në nenin 123 par.1 pika a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit të Doganave dhe të Akcizës është paraparë shprehimisht që *“Dokumentet në vijim duhet bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*. Nga kuptim të këtyre dispozitave ligjore, paditësi ka pasur detyrim ligjore që në procedurë të zhdoganimit të mallit tek e paditura të paraqes jo vetëm faturën e blerjes së mallit nr.1000001132 të datës 05.04.2017 siç në realitet ka vepruar i njëjti por edhe letër kreditin me nr.1000001143 të datës 12.04.2017 pasi që ky dokument i ishte lëshuar paditësit nga eksportuesi me datë 12.04.2017 pra një ditë më herët

nga deklarimi i mallit për zhdoganim, dhe se me të njëjtin ishte korigjuar fatura e blerjes së mallit. Pra nga kjo rezulton se ky dokument ka qenë i disponueshëm për tu bashkangjitur dokumentacionit përcjellës të mallit dhe duke qenë se ky dokument nuk është paraqitur në këtë fazë, gjykata ka konstatuar se e paditura me të drejtë konstatimin e gjendjes faktike për deklarim jo të saktë të vlerës së mallit e ka bërë bazuar në dokumentacionin e prezantuar nga paditësi dhe vlerën e deklaruar në DUD, ku çmimi i deklaruar ishte zbritur pa pasur mbështetje në dokumentacion relevant. Gjykata nga administrimi i provave nuk ka mundur të vërtetoj se janë bërë shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale. Andaj, nga provat e administruara në procedurën e konfliktit administrativ nuk janë paraqitur prova të bazuara nga të cilat do të vërtetohej se nuk është përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes doganore nga neni 276 pika (k) të KDAK-së, i cili përcakton se: personi juridik apo fizik, në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshinë tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritje ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo realja, do të gjohet me gjobë në shumë prej pesëqind (500.00) deri në dhjetëmijë (10,000.00) Euro, bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 04/L-099, për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109, sipas të cilit për të gjitha shkeljet e parapara në nenin 276, do të gjohet me gjobë në të holla në shumë prej pesëqindë (500) deri në dhjetëmijë (10,000.00) Euro. Nuk është kontestuese ne ankesën e ankuesit se letër kredit nr. 1000001143 dt. 12.04.2017, nuk është bashkangjitur deklaratës doganore ne rastin e zhdoganimit te mallin lëndor, mirëpo është paraqitur gjate fazës e ankesës ne procedure administrative, andaj paditësi ka dështuar te paraqes dokumentacionin përcjellës te mallit lëndor ne përputhej me dispozitave ligjore te KDAK-se dhe si rezultat i kësaj e paditura ka zbatuar drejte dispozitat ligjore ndëshkues pasi qe paditësi ne rastin konkret ka kryer kundërvajtës doganore e cila i vihet ne barre ne përputhje me nenin 276 pika (k) të KDAK-se. Gjykata konsideron se mosdija për legjislacionin në fuqi nuk e liron paditësin nga përgjegjësia e kundërvajtjes doganore.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjen se gjykata e shkallës së parë, nga dëshmitë e nxjerra me të drejt ka konstatuar se Dogana e Kosovës, ka vepruar drejt kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e subjektit në procedurë. Sepse, paditësi nuk ka arritur që të paraqes prova të mjaftueshme që dëshmojnë të kundërtën e konstatimeve nga vendimi i kontestuar i të paditurës. Andaj, gjykata nga provat materiale të shqyrtuara edhe në procedurën administrative, si dhe bazuar në nenin 273 par.2 të KDAK-së është parashikuar “Duke përjashtuar rastet e fuqisë madhore, çdo veprim ose mosveprim, që bie ndesh me dispozitat e parashikuara me këtë Kod, me aktet nënligjore për zbatimin e tij me dispozitat tjera në fuqi në Kosovë, quhet Kundërvajtje Administrative Doganore”. Në dispozitat ligjore të cituara dhe gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë duke pas parasysh edhe faktin se paditësi edhe më herët ka kryer kundërvajtje doganore e vërtetuar, gjykata konkludon se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësin e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore dhe i ka shqiptuar gjobën në të holla në shumë prej 4,807.14€, për shkak se i njëjti kontorllës doganore nuk i ka paraqitur vlerën e saktë të mallit me anë të deklaratës doganore R-8897/13.04.2017, me çka ka rezultuar se ka tentuar ti shmanget pagesës së taksave doganore në vlerë prej 1,602.38€. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate nuk i merr si të bazuara pretendimet se e paditura dhe gjykata e shkallës së parë gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike, dhe me këtë rast gabimisht kanë aplikuar edhe dispozitat ligjore. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat

i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt, kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet e paditësit të përsëritura të një pas njëshme në organin e paditur ashtu si dhe në gjykatë, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara, për tu aprovuar ankesa, dhe për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit dhe lënies në fuqi të aktvendimit të lartcekur, e pasi që me thëniet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.101/22, me datë 06.03.2023

**Kryetar i Kolegjit,
Ramush Bardiqi**